

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion

1. Si paraqitet niveli i papunësisë në vendin tonë në 6 mujorin e parë të vitit 2022?

Gjatë 6-mujorit të parë të 2022 në zyrat e punësimit rezultojn të regjistruar **75,849** punëkërkues të papunë.

2. Cilat janë të dhënat sipas llojeve të papunësisë, duke u ndalur tek papunësia strukturore?

Prej totalit të punëkërkuesve të regjistruar rezultojnë:

- 54% femra
- 35% kryefamiljarë
- 64% mbi 40 vjeç
- 56% me arsim deri 9 vjeçar
- 37% në ndihmë ekonomike
- 3% në pagesë papunësie
- 10% romë/egjiptianë

3. Sa qytetarë kanë aplikuar për punë për 6 mujorin parë të 2022 dhe cilat janë shkaqet për personat të cilët nuk pranohen?

Gjatë 6-mujorit të parë të 2022 në regjistër kanë hyrë 14,290 punëkërkues të papunë. Disa nga shkaqet të cilat vështirësojnë integrimin e punëkërkuesve të papunë në tregun e punës janë moshë, arsimi, mungesa e një profesioni, afatgjatësia në papunësi, problematikat, shëndetësore dhe sociale.

4. Për çfarë pozicioni pune interesohen më shumë dhe më pak qytetarët?

Bazuar në informacionet që ka institucioni jonë për profesionet e dëshiruara nga punëkërkuesit ata interesohen më tepër për pozicionet e punës të mirëpaguara gjithashtu të kenë kushte të mira pune.

5. Sa vende të lira pune ka deri më tani?

Gjatë periudhës Janar- Korrik 2022 në Zyrat e Punësimit u shpallën 23,229 vende të lira pune (VLP) ose 84% më shumë se e njëjta periudhë krahasuar me një vit më parë.

6. Cila moshë mbizotëron më shumë për kërkimin e punës? Po gjinia?

Në regjistër rezulton se 64% e punëkërkuesve të regjistruar janë mbi moshën 40 vjeç dhe 54% janë femra.

7. Si paraqiten shifrat krahasuar të njëjtën periudhë të një viti më parë?

Gjatë 6-mujorit të parë të 2022 janë regjistruar 13% më pak punëkërkues të papunë krahasuar me një vit më parë.

8. Si paraqitet papunësia sipas qyteteve?

Më poshtë paraqitja e shkallës së papunësisë sipas Rajonit në vitin 2021 bazuar në të dhënat e paraqitura nga INSTAT.

Rajonet	Shkalla e papunësisë sipas Qarku për vitin 2021 sipas INSTAT
Berat	6,5
Dibër	11,9
Durrës	16,1
Elbasan	6,9
Fier	8,7
Gjirokastër	4,7
Korcë	9,7
Kukës	4,0
Lezhë	22,6
Shkodër	12,1
Tiranë	11,8
Vlorë	19,5

9. Cilat janë disa nga shkaqet e papunësisë?

Shkaqet e papunësisë primare janë mungesa e arsimit, kualifikimit apo grupmosha e madhe e punëkërkuësve. Kërkesat e punëkërkuësve nuk përshtaten plotësisht me ofertën e prezantuar për vendet e lira të punës të shpallura nga punëdhënësi. Sipasoj kjo ndikon në integrimin në tregun e punës të punëkërkuësve.